



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2360, datë 27.09.2013

Për

**“Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communication sh.a. ndaj
Vendimit nr.2339, datë 31.07.2013 për "Përcaktimin e sipermarrësit Albanian
Mobile Communication sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e
thirrjeve në rrjetin publik AMC drejt numrave gjeografikë dhe vendosjen e masave
rregulluese”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Znj. Alketa	Mukavelati	Kryetare
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Znj. Elkeda	Domi	Anëtare
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Mirela Xhelaj, në mbledhjen e datës _____.____.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”), ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimi i ankimit administrativ të Albanian Mobile Communication sh.a. ndaj Vendimit nr. 2339, datë 31.07.2013 për "Përcaktimin e sipermarrësit Albanian Mobile Communication sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik AMC drejt numrave gjeografikë dhe vendosjen e masave rregulluese".

BAZA LIGJORE:

1. Neni 8, neni 31 e në vijim, nenit 52, pika 1 e nenit 114, pika 1 e nenit 115, nenet 107 dhe 120/1 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**Ligji nr. 9918**);

2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (K.Pr.A);
3. “Rregullore për analizën e tregut”, miratuar me vendimin nr. 747, datë 17.07.2009, te Keshillit Drejtues të AKEP (Rregullorja).
4. Pika 17, e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP” (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim nr. 170, datë 24.04.2004 të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e AMC me nr. 4326/1Prot., datë 30.8.2013 (nr. 1477Prot. i AKEP, datë 2.9.2013) me të cilën ka paraqitur ankim administrativ ndaj Vendimit nr. 2339, datë 31.7.2013 për “Përcaktimin e sipërmarrësët Albanian Mobile Communication sh.a sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik AMC drejt numrave gjeografikë fiks dhe vendosjen e masave rregulluese”.
2. Vendim Nr. 2336 date 30.07.2013, Për “Miratimin e Dokumentit: Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar”,
3. Vendimit nr. 2339, datë 31.07. 2013 për "Përcaktimin e sipërmarrësit Albanian Mobile Communication sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik AMC drejt numrave gjeografikë dhe vendosjen e masave rregulluese".
4. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N :

- 1) Albanian Mobile Communication sh.a. me anë të shkresës nr. 4326/1Prot., datë 30.8.2013 ka paraqitur ankim administrativ ndaj Vendimit nr. 2339, datë 31.7.2013 për “Përcaktimin e sipërmarrësët Albanian Mobile Communication sh.a sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik AMC drejt numrave gjeografikë fiks dhe vendosjen e masave rregulluese”.
- 2) AMC në lidhje me këtë ankim paraqet argumentet e saj si më poshtë:
 1. AMC shpjegon se sic është shprehur edhe komentet e saj datë 3.01.2012 i qëndron argumentit se terminimi i thirrjeve në rrjetin e secilit operator alternativ fiks përbën një treg përkatës të vecantë, të identifikuar nga tregjet e tjerë me shumicë, për shkak të pamundësisë për të pasur akses në këtë treg nga ana e operatorëve të tjerë për të ofruar shërbimin përkatës të terminimit në rrjetin e cdo operatori alternativ fiks, si dhe të mungesës së alternativave të tjera zëvendësuese.

Tregu i terminimit nga vendndodhje fikse është i identifikuar si i tillë edhe në të dy rekomandimet e BE-së përkatësisht të vitit 2003 ashtu dhe të vitit 2007, paverësisht nëse operatori fikse është alternativ ose inkumbent, duke pasur një kontroll 100% të këtij tregu në rrjetet përkatës.

2. Shoqëria AMC vlerëson se për të vendosur masa rregullatore dhe për të shpallur një operator OFNT duhet të arsyetosh nëse përmbushet kriteri i dominancës referuar edhe kërkesave të nenit 33 të Ligjit 9918 datë 19.5.2008 "*Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar.
3. AMC shprehet se në mënyrë që të garantohet respektimi i parimit të proporcionalitetit (*neni 11 i Kodit të Procedurave Administrative*) por dhe kërkesat e Kreut VI të Ligjit 9918, datë 19.5.2008 "*Për Komunikimin Elektronike në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, rregullimi i tarifave duhet të kryhet sipas modelit të analizës së kostove, sic edhe ka ndodhur në mënyrë të ngjashme me operatorët celularë. Vetëm kështu AKEP do të garantojë mosdiskriminim mes operatorëve në treg.
4. AMC sqaron se AKEP është shprehur mbi faktorët e analizuar, si pjesë tregu, fuqi kundërvepruese dhe nivelin e mosmarrvëshje për shërbimin e terminimit në rrjetet e operatorëve alternativë. Në kuadër të kësaj analize, dhe vecanërisht duke gjykuar mbi pjesën e tregut, gjykojmë që nuk janë përmbushur kushtet për shpalljen e AMC si OFNT në këtë treg.
5. AMC vlerëson se e gjen të pabazuar në kuadrin ekzistues rregullator si të vendit tonë por edhe të normave të BE arsyetimin sipas të cilit shpallja OFNT dhe vendosja e masave rregullatore justifikohet për shkak të nivelit apo intensitetit të mosmarrvëshjeve në treg ndërmjet operatorëve, ndërkohë që nëse gjykohet mbi pjesët e tregut asnjë operator alternativ, aq më tepër AMC nuk plotëson kushtet për dominancë.
6. Për të qenë dominant në një treg të caktuar në kuptim të këtyre akteve por edhe në zbatim të nenit 33 të ligjit 9918, datë 19.5.2008 "*Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar disa nga kushtet janë:
 - a) kuota në përqindje e kontrollit në treg;
 - b) dimensionin e operatorit;
 - c) avantazhet dhe superioritetin teknologjik në treg;
 - d) mungesa e fuqisë kundërvepruese;
 - d) akses i privilegjuar në burimet financiare;
 - e) ekonomia e shkallës dhe densitetit;
 - f) integrimi vertikal;
 - g) mungesa e një konkurrence potenciale etj.
7. Në lidhje me kuotën e kontrollit në treg, AMC sqaron se pozita dominante e një operatori ekziston nëse ky i fundit zotëron më shumë se 25% të tregut i vetëm. AMC Fiks si dhe operatorët e tjerë alternativë kanë kuota shumë më të ulta se 25% në treg si në terma abonentësh ashtu dhe në terma të të ardhurave në nivele, përkatësisht 24% dhe 16% për të gjithë operatorët alternativë së bashku në total ndërsa operatori inkumbent Albtelecom zotëron kuota tepër të larta në nivel 76% dhe 84% AMC Fix zotëron vetëm 2% të tregut. Kjo është një situatë gati

- monopoliste e operatorit inkumbent, dhe ky kriter nuk plotësohet për AMC fix apo edhe operatorët alternativë për t'u përcaktuar edhe atë si OFNT
8. AMC shpjegon se fuqia e lartë kundërvepruese e operatorit inkumbent Albtelecom në blerjen e terminimit në rrjetet e operatorëve alternativë, duke bërë që këta operatorë të mos kenë një aftësi të plotë ndikuese në tarifatat e terminimit që ata përcaktojnë në lidhje me operatorët e tjerë.
 9. AMC vlerëson se një tjetër faktor që duhet marrë parasysh është dhe barriera që hasin këta operatorë gjatë të tyre, dhe për shkak të dimensionit të vogël që kanë, nuk kanë mundësi ekspansioni siç gëzon Albtelecom si operator i inkumbent në tregun e telefonisë fikse.
 10. AMC shprehet se një pjesë e madhe e kriterëve si superioriteti në teknologji apo aksesin në burimet financiare nuk plotëson kushtin që operatorët alternativë të kenë FNT në tregjet përkatëse të terminimit.
 11. Praktikën për përcaktimin e FNT midis operatorëve alternativë dhe atyre inkumbent është e ndryshme, midis vendeve të ndryshme të BE-së por dhe të rajonit, duke pasur një asimetri në përcaktimin me FNT midis operatorëve alternativë dhe atij inkumbent, siç ndodh në disa vende si: Qipro, Irlandë, Poloni, Rumani, duke iu referuar raportit të BE-së "European Union 2011 Telecommunication, Market and Regulatory Developments".
 12. Trajtimi që bëhet AKEP midis operatorëve alternativë dhe AMC Fiks rezultoi diskriminues, pasi operatorët alternativë fikse në momentin që kanë hyrë në tregun e telefonisë fikse nuk kanë pasur statusin e FNT-së në tregjet përkatëse të terminimit në rrjetet e tyre fikse. Ndërsa AMC e cila ka pak kohë që është aktive në tregun e telefonisë fikse AKEP propozon përcaktimin FNT në tregun e terminimit. Kjo sjellje është në kundërshtim me parimet bazë rregullatore atë të mosdiskriminimit.
 13. AKEP shprehet se AMC përmbush kushtet për t'u shpallur FNT në tregun e terminimit të thirrjeve drejt pajtimtarëve të AMC Fix dhe nuk përmend se cilat kushte përmbush për t'u shpallur FNT. AMC argumenton se AKEP duhet që të lërë gjithë operatorët alternativë përfshirë edhe AMC fikse pa statusin FNT në tregun e terminimit në rrjetin përkatës siç kanë qenë më parë. Përcaktimi i FNT i AMC është një barrë e rëndë që i vihet për shkak të dimensionit të vogël në treg, pavarësisht përkufizimit për tregun e terminimit ajo kontrollon 100% të tregjeve përkatës.
 14. Shoqëria AMC shpjegon se vlera e tarifave të prezantuar në keshillimin publik dhe vlerat e reja të tarifave të terminimit në vendimin përfundimtar dhe periudhat ndryshojnë. Kjo sjell që të ketë konfuzion dhe të mos lejojë buxhetimin e bizneseve. Për këtë arsye shfuqizimi do të sillte normalizimin e situatës së krijuar.
 15. Në përfundim AMC kërkon nga AKEP shqyrtimin e ankimit administrativ, pranimin e tij dhe shfuqizimin e Vendimit nr. 2339, datë 31. 07. 2013 për "Përcaktimin e sipërmarrësit Albanian Mobile Communication sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik AMC drejt numrave gjeografikë dhe vendosjen e masave rregulluese".

3) AKEP pasi ka shqyrtuar sa më lart parashtron AMC arsyeton se:

- a. Argumenti i AMC për pjesën e tregut për terminimin e thirrjeve është kontradiktor pasi në pikën 1 AMC pranon se secili operator ka 100% pjesë tregu për terminimin e thirrjeve (që është dhe reale për tregun përkatës të analizuar) ndërsa në pikën 7 argumenton se AMC ka vetëm 2% pjesë tregu dhe të gjithë operatorët alternativë së bashku kanë 24% dhe 16% për pajtimat dhe të ardhura. Theksojmë se pjesa e tregut i referohet tregut përkatës me shumicë të terminimit dhe jo tregut me pakicë të thirrjeve, abonentëve apo një kombinim i tregjeve me pakice dhe me shumicë. Pra kriteri i pikës a të nenit 33 të ligjit 9918, të referuar në pikën 6 i referohet kuotës së kontrollit të **tregut përkatës** dhe të gjithë sektorit të komunikimeve elektronike në Shqipëri.
- b. AMC ka keqkuptim në mënyrën e analizimit të pjesëve të tregut për FNT, kur citon në pikën 7 nivelin prag prej 25%. Kujtojmë AMC se ky nivel përdorej në kuadrin ligjor të vjetër të AKEP, i shfuqizuar në 2008 me hyrjen në fuqi të ligjit 9918, apo kuadri 1998 i BE i zëvendësuar me kuadrin rregullator 2002.
- c. Për sa i përket faktorëve të tjerë, AKEP ka argumentuar se pikërisht aplikimi nga AMC i tarifave të ndryshme të terminimit për AMC sipas operatorëve, si dhe avantazhet që ka AMC ndaj të gjithë operatorëve fiks për lehtësinë e mbulimit të gjithë territorit me rrjet për ofrimin e AMC fiks, përbëjnë argumenta shtesë për FNT të AMC për terminimin në AMC fiks, në kushtet kur ka pjesë tregu 100% për këtë shërbim.
- d. AMC plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 33 të ligjit nr. 9918, të cituara në pikën 6. Pikat a - d janë vënë në dukje në dokumentin e Analizës si dhe më sipër, ndërsa theksojmë se AMC plotëson dhe kriteret e tjera si akses më të madh në burime financiare, avantazhe të ekonomive të shkallës për shkak të madhësisë (i vetmi operator që ka mbulim me rrejt në mbi 90% të territorit dhe 99% të popullsisë për ofrim shërbimi telefonie fikse), integrim vertikal (si gjithë operatorët e tjerë fiks), dhe nuk ndeshet me konkurrencë potenciale për terminimin në rrjetin e saj.
- e. Për sa i përket argumentave të AMC për ndryshim të vlerave të tarifave të terminimit në rrjetin AMC për AMC fiks nga konsultimi publik në versionin final dhe parashikimeve në buxhet nga AMC, theksojmë se tarifat e miratuara nga AKEP në versionin final të analizës dhe në VKD nr. 2339, datë 31.07.2013, janë më të larta se ato të parashikuara në konsultim publik për të njëjtën periudhë kohore, pra duke pasur efekt pozitiv për AMC për terminimin e thirrjeve në rrjetin e saj.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, gërma a) , të K.Pr.A, si dhe pikën 17, të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Lënien në fuqi të aktit administrativ: Vendim i Këshillit Drejtues nr. 2339, datë 31.7.2013 dhe rrëzimin e ankimit administrativ të AMC sh.a. të paraqitur me shkresën nr. 4326/1Prot., datë 30.8.2013 ndaj Vendimit nr. 2339, datë 31.7.2013 për *“Përcaktimin e sipërmarrësët Albanian Mobile Communication sh.a sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik AMC drejt numrave gjeografikë fiks dhe vendosjen e masave rregulluese”*.
2. Të njoftohet AMC sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi;
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R E

Alketa MUKAVELATI

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Elkeda DOMI**
4. **Zamira NURÇE**